

H Y L L I I D R I T Ë S

E PËRKOHSHME KULTURORE - LETRARE

EDITORIAL

Drejtësi e solidaritet vllaznor 5

GJUHËSI

Bardhyl DEMIRAJ

Alfabeti origjinal i Dhaskal Todhrit në fokusin e analizave etno-kulturore dhe epigrafike të Johan Georg von Hahn-it 8

Anila OMARI

Një tekst i shkurtër shqip dhe emri “shqiptar” në një dorëshkrim të vitit 1639 36

Evalda PACI

La filologia bizantina e le ricerche degli studiosi arbëreshe sulla letteratura scritta albanese (ovvero i più antichi testi scritti in albanese) 47

Majlinda BREGASI

Hapësira, gjuha dhe ‘cognition’
“Lahuta e Malcís” – At’ Gjergj Fishta 53

LETËRSI

Kujtim M. SHALA

Kryevepra e Fishtës 62

Lisandri KOLA Át Benedikt Dema, O.F.M., <i>Fjalori Historik - Gjeografik - Mytologjik i "Lahutës së Malcís"</i>	100
Agron Y. GASHI Pashko Vasa: autobiografia dhe ideografia	106
Alfred ÇAPALIKU Injac Zamputti koleg me Ndre Mjedën	115
Elsa SKËNDERI <i>"Këtë libër do ta shkruaj përsëri"</i> – Poezia scriptible e Teki Dërvishit	119
Meliza KRASNIQI Kuteli im	129
Ndue UKAJ Pjetër Bogdani - shkrimtar dhe prijës	138
Anxhela LEPURI Daniele Del Giudice, dishepulli i Italo Kalvinos	149
 <i>SOCIOLOGJI</i>	
Oreste PARISE La maturazione socio-politica di Francesco Antonio Santori	155
 <i>HISTORI</i>	
Bardhyl DEMIRAJ Një portret ende i panjohur i Gjon. P. Nikollë Kazazit (rivlerësim)	187
Juljan VLASHI Kishat e Kryezezit, Bulgrit dhe Velës	190
 <i>ARKEOLOGJI</i>	
Gëzim HOXHA Troshani, kishat, Kuvendi Françeskan dhe kolegji i tij	211

NEKROLOGJI

Peter BARTL (1938–2022) 227

Traueransprache bei der Beisetzung Peter Bartls 229

Grigore BRÂNCUȘ (1929–2022) 234

BRILANTE BIBLIKE

Át Daniel GJEÇAJ, O.F.M.
Libri i Isaisë Profet 237

ARKIVI I HYLLIT

Át Marin SIRDANI, O.F.M.
THRAKJA (Thracia) 261

BARDHYL DEMIRAJ

Alfabeti origjinal i Dhaskal Todhrit në fokusin e analizave etno-kulturore dhe epigrafike të Johan Georg von Hahn-it

1. Fjalë hyrëse

Objekt i këtij shkrimi është alfabeti origjinal i gjuhës shqipe në disa dorëshkrime që i takojnë gjysmës së parë të shek. XIX, të cilat jubilarin ynë, Johann Georg von Hahn i kërkoi, i gjeti dhe i siguroi, më saktë iu dhuruan gjatë qëndrimit të tij në Elbasan në vitin 1849. Është pikërisht ky alfabet – i njohur ndërkohë si alfabeti i Dhaskal Todhrit – që Hahn-i e rroku në fokusin e një studimi të mirëfilltë epigrafik dhe etno-kulturore, duke ia përcjellë atë rretheve shkencore-intelektuale të kohës, fillimisht thukët në një raport paraprak të po atij viti (Hahn 1849 6vv., 262v.) e në një parashtesë shumë më të zgjeruar një vit më vonë (Hahn 1850 1-27), duke ndërmarrë më pas do rregullime dhe plotësime të rastit që i rroku së bashku në bleun e parë të veprës së tij madhore “Albanesische Studien” (AS I, Wien 1854 280-299). Pas një paraqitjeje tabelare Hahn-i e shtjellon këtë alfabet në mënyrë sistematike, duke u rrekur të përsiasë qoftë burimin e kodit në tërësinë e tij, ashtu edhe vendin e tij në matriksin e kulturës etnike shqiptare qysh prej periudhave të antikitetit të kryehershëm, përkatësisht deri në atë periudhë të errët që përkon me ngulimet greke në Jug të Ballkanit. Me këtë studim Hahn-i hap njëherësh edhe siparin e epigrafikës shqiptare, si disiplinë e mirëfilltë në kulturën e shkrimit shqip.

Qëllimi i shkrimit në vetvete është modest, në kuptimin që jemi mjaftuar t'i përcjellim lexuesit rezultatet e analizës epigrafike në ndërthurje me atë etno-kulturore që realizon Hahn-i në këtë studim, së bashku me krehjen e argumenteve *pro & contra* që mbështesin, përkatësisht kundërshtojnë përsiatjet e tij mbi zanafillën e këtij kodi. Vëmë në dukje gjithashtu që nuk mëtojmë assesi zgjidhje përfundimtare të qerthullit problemor që parakuptojnë studime të kësaj natyre. Më fort synojmë: a) së pari të riaktivizojmë një debat të mirëfilltë shkencor që e ka mbyllur paletën e tij qysh në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX; dhe b) së dyti të përballemi me një farë “glorifikimi” pa kurrfarë baze shkencore që po përjeton ky kod alfabetik në botimet akademike

alternative të kohës sonë¹.

Struktura e studimit i përmbahet kështu qëllimit të kumtuar: a) Pas një paraqitjeje të thukët të materialeve në dorëshkrim që disponojmë me këtë alfabet, sikurse b) historikut të studimit, do të ndalemi më gjerë c) në punën dhe rezultatet konkrete që arriti Hahn-i gjatë shqyrtimit të kodit alfabetik që sendërton gjithë këtë material, duke konsultuar njëherësh si d) kritikën shkencore të zhvilluar deri sot, ashtu edhe e) sfondin kulturor-historik që ka përjetuar shkrimi shqip me alfabet origjinale në kohë dhe hapësirë, çka mundëson së fundi f) nxitjen e diskursit shkencor në kohën tonë për një fushë që ka mbetur dhe mbetet e palëvruar si duhet në studimet filologjike bashkëkohore.

2. Fate emrash dhe materialesh në dorëshkrim

Materiali në dorëshkrim i siguruar në shek. XIX lidhet pandërmjetshëm me kërkimet dhe gjetjet e Hahn-it në terren (Elbasan më 1849²). Gjithsesi mbledhje materiali dorëshkrimor me këtë alfabet nuk rrudhen thjesht vetëm me emrin e këtij dijetari. Në gjurmët e tij udhojnë në kapërcyell të shek. XIX-XX me kërkime, gjetje dhe mbledhje të reja Gjergj Pekmezi (1900³) e më pas edhe Lef Nosi (1918⁴).

2.1 Dorëshkrime të mbledhura prej J. G. von Hahn-it

Siç mësojmë edhe në kumtin e parë të Hahn-it, nxitës për kërkimet e tij në terren (Elbasan 1849) ishin do vëzhgime të studiuesit erudit italo-arbëresh Giuseppe Crispi ([1836 126] 2003 139) ndaj një alfabeti të hershëm shqip me shkronja origjinale që qarkullonte në do ngulime arbëreshe në rrethinat e Napolit. Kështu sipas tij:

“Gjatë punës sime mbi gjuhën shqipe kam dëgjuar mbi alfabetin që përdoret vise-vise për shënime kishtare. Meqë Crispi në shënimin e tij lidhur me shkrimin në gjuhën shqipe e përmend faktin se ky alfabet është tejet i vjetër, jam rrekur ta siguroj me çdo mënyrë. Para pak kohësh ia dola mbanë: Gjeta jo vetëm ABC-në, por edhe një dorëshkrim të shkruar me të, një përkthim të homilive greke që vështirë se mund të jetë më i vjetër se 50-vjeçar, sepse personi që e ka shkruar këtë në rininë e vet, jeton ende. Në pamje të parë ky alfabet ishte për mua krejt i huaj. M’u duk se dallonte shumë nga të gjitha

¹ Shih së fundi Zhang 2019.

² Shih më poshtë shën. 5.

³ Shih § 2.2.

⁴ Shih § 2.3, shën. 15.

alfabetet e njohura. Shqyrtimi më i detajuar dha rezultate mjaft interesante. I tërë alfabeti ka 52 shenja dhe janë në një renditje që s'ka asgjë të përbashkët me shenjat e zakonshme dhe që të kujton, ndonëse së largu, alfabetin arab. Pas veçimit të së paku 13 shkronjave dyshe mbeten 39 shkronja të thjeshta" (Hahn: 1849 6v.)⁵

Në dy shkrimet e tij të radhës Hahn-i mëngon të pohojë edhe traditën gojore, të fiksuar atëbotë⁶ në kujtesën kolektive të qytetit që e lidhte pandërmjetshëm këtë kulturë shkrimi shqip me një mësues dhe predikues të qytetit me emrin (gjerm.) <Teodor> aty nga fundi i shekullit XVIII. Sipas tij:

"Ky alfabet, si rrjedhojë e të dhënave të derisotme, duket se është anas vetëm në këtë qytet. Në Durrës dhe Shkodër ai vetë është njëlloj i panjohur, sikurse edhe gjithë Toskërinë (Epirin); vetëm në jug në qytetin fqinjë të Beratit kuptohet dhe përdoret aty-këtu⁷.

Në Elbasan përdorimi i këtij alfabeti nuk kufizohet vetëm për qëllime kishtarë, ai përdoret aty edhe nga shumë tregtarë në korrespondencë me patriotë të larg vendit; disa mbajnë madje edhe librat [e llogarisë] në këtë shkrim. Veçse numri i atyre që e zotërojnë atë vështirë se e kalon numrin 50.

Tradita e bashkëlidh këtë shkrim me një mësues të shkollës së atjeshme greqisht, të quajtur <Teodor>, i cili ishte njëkohësisht edhe predikues i qytetit dhe një njeri i shumë i ditur. Veçse askush nuk di të thotë, nëse ishte ai që e kishte zhvilluar këtë alfabet apo e kishte sjellë atë në qytet. Ky person duhet të kishte përkthyer jo vetëm Testamentin e Ri, por edhe Testamentin e Vjetër në shqip (sipas Septuaginta-s, sepse ai nuk dinte hebraisht) dhe se ishte marrë madje edhe me krijimin e një gjuhe të përbashkët ndaj dy dialekteve që largoheshin shumë prej njëri-tjetrit. Për fat të keq të gjitha shkrimet e tij u dogjën prej farefisit pas një epidemie murtaje

⁵ Shih Nahtigal [1923] 2015b 61v. (përkth. Nikollë Berishaj)

⁶ Nahtigal [1923] 2015b 63v. Shih edhe Shuteriqi (1976 276), sipas të cilit ishte Konstandin Kristoforidhi ai që e shoqëroi Hahn-in më 1849 gjatë kësaj vizite në Elbasan. Po aty Shuteriqi vëren se Hahn-i e bëri të njohur zbulimin e alfabetit të Dhaskal Todhrit më dt. 24 dhjetor 1849 në shtypin e Janinës. Gjithsesi kumtet e para të Hahn-it mbi këtë zbulim i ndeshim të shkruara thukët në: "Sitzungsberichte der philos.-hist. Classe der Akad. der Wissenschaften. Wien, bl. III; viti 1849; fletore 6-10, f. 262-263.

⁷ Pas gjase kemi këtu një ngatërresë me një tjetër alfabet origjinal, që është i fiksuar edhe në Kodikun Beratas (Demiraj 2019 229, 233). Për keqkuptime të kësaj natyre shih edhe Resulin (1938 181), kur kundërshton me të drejtë Mitkë Qafëzez (1937a 3; sh. edhe 1937b 247), i cili vë shenjë e barazimit midis të dy alfabeveve.

nga frika e ngjitjes.⁸ Sipas moshës së të afërmeve bashkëkohës, ai duhej të kishte vdekur aty nga fundi i shekullit të kaluar (= shek. XVIII). Ai paskësh studiuar në Voskopojë, dhjetë orë larg në lindje të Beratit. Kjo (= Voskopoja) ishte deri në gjysmën e shekullit të kaluar qyteti më i zhvilluar në gjithë Shqipërinë; në të funksiononte qysh prej mesjetës një shkollë e njohur, madje edhe një shtypshkronjë...” (Hahn AS I, f. 296)

Pa dashur të ndalemi hollësisht në plotësimet dhe përmirësimet e rastit që kanë përjetuar në kohën tonë pjesë të këtij kumti ndaj mbiemrit dhe prurjeve të eruditit elbasanas <Teodor> në kulturën e shkrimit shqip (shih §2.4) le të njihemi fillimisht edhe me materialin e mbledhur në terren prej Hahn-it d.v., ashtu siç kumton në vazhdim që:

“Autori kërkoi më kot në Elbasan dorëshkrime nacionale [= të natyrës kombëtare laike] me këtë alfabet. Dy fletore me nga njëra 7 dhe tjetra 12 fletë në format quart (1/4) që përmbajnë fragmente përkthimi gegnisht prej horologionit greqisht si edhe një përkthimi njëfletësh gegnisht të një fragmenti prej Ungjillit të Gjonit përbëjnë të vetmen pre [= mbledhje]. Personi, që pas gjase duhet të ketë shkruar më të hershmin [dorëshkrim] në rini të vet, jeton ende⁹. Prashtu asnjë prej këtyre fragmenteve nuk mund të jetë më i hershëm se 50 vjet.” (Hahn AS I, f. 297¹⁰)

Sa u përket fateve të këtij materiali në dorëshkrim, lejohemi të shtojmë thukët që, pas vdekjes së Hahn-it (23 shtator 1969), ai kaloi i tëri si trashëgimi në pronësinë e të vëllait Friedrich von Hahn, i cili ia përcolli atë më tej sllavistit dhe filologut Leopold Geitler (Agram/Zagreb). Siç do të vërejmë më poshtë, Geitler-i është studiuesi i dytë i radhës, i cili iu përkushtua, sikurse Hahn-i, kryesisht studimit epigrafik, përkatësisht historisë dhe burimit të kodit alfabetik të përdorur në këto materiale. Pas botimit të veprës së tij “Die albanesischen und slavischen Schriften” (Wien 1883) Geitler-i në mirëkuptim me Friedrich von Hahn-in ia përcolli këtë material si dhuratë Bibliotekës Mbretërore të Vjenës (sot Biblioteka Kombëtare Austriake – ÖNB), ku ndodhet i depozituar

⁸ Shuteriqi (1976 156) sqaron me këtë rast se bëhet fjalë këtu për epideminë e murtajës që pllakosi në Elbasan në vitin 1827, veçse përgjegjësinë e djegies së këtyre materialeve ia ngarkon institucionit të Kishës Ortodokse në qytet.

⁹ Nosi 1 [1918] 13; Nahtigal [1923] 2015b 71vv. Sipas Shuteriqit (1976 156) „Ky njeri duhet të ketë qenë Haxhi Josifi...” (shih më poshtë § 2.3)

¹⁰ Citati origjinal: “...zwei Hefte, das eine von 7, das andere von 12 Quartblättern, Fragmente gegischer Uebersetzung aus dem griechischen Horologion enthaltend, und eine auf einen Foliobogen geschriebene gegische Uebersetzung eines Fragmenten aus dem Evangelium Johannis bilden seine einzige Ausbeute.” (Hahn 1854 297). Shih edhe Hahn 1850 24v.

sot e gjithë ditën.¹¹

Vlen të shtojmë së fundi që këto materiale në dorëshkrim të depozituara në ÖNB nuk ishin bërë deri në dhjetëvjeçarin e dytë të këtij shekulli objekt hulumtimi dhe edicioni kritik të mirëfilltë, përpos a) ndonjë teksti të botuar si foto-faksimile me lutje në shkrimin e dytë të Hahn-it (1850: një fletë e panumëruar e ndërmjet f. 26-27); dhe b) një fletë tjetër faksimile së bashku me riprodhimin diplomatik të një pjesë të Ungjillit sipas Gjonit (Kap. XVI) në shkrimin e tij të fundit (Hahn 1854 298vv.¹²). Është një meritë e radhës për studiuesin erudit Robert Elsie (2016; 2017 *passim*), i cili u fokusua në kërkimin dhe “rizbulimin” e këtij materiali në ÖNB, duke ndërmarrë klasifikimin e materialit së bashku me transliterimin përkatës dhe përkthimin e tij anglisht, çka e lehtëson tej mase studimin e mirëfilltë filologjik dhe edicionin kritik të të gjithë materialit.

2.2 Dorëshkrime të mbledhura prej Gjergj Pekmezit

Dorëshkrime elbasanase me alfabetin në fjalë, të shkruara nga duar të ndryshme e që u takonin po ashtu periudhave të ndryshme kohore (shek. XVIII-XIX) sinjalizoi në kapërcyell të shek. XIX Gjergj Pekmezi po në qytetin e Elbasanit në kuadrin e një ekspedite në terren në korrik të vitit 1900. Në raportin e tij, botuar një vit më pas, Pekmezi (1901 54v., 57vv.) informon fillimisht mbi një trashëgimi dorëshkrimesh postume të mësuesit të ri elbasanas Dhimitër Ndre Pina (Demetrios Andrea Pina – ⁺27 vjeç), në të cilën, përpos teksteve gegnisht me Alfabetin e Stambollit, gjendej edhe një fletore si edhe disa fletë të shkëputura me ligjërime dhe këngë fetare “në shkrimin elbasanas, të bërë të njohur dikur prej Hahn-it dhe Geitler-it.” Këtyre dorëshkrimeve postume të Pinas që kishte dhënë frymën e fundit “para pak vitesh” (f. 54), u prinin një numër i konsiderueshëm dorëshkrimesh me të njëjtin alfabet, të cilat Pekmezi i gjeti të lëna në mëshirë të fatit rrëzë një altari anësor në kishën e Manastirit të Shën Gjon Vladimirit (Shijon). Për to e paskësh ndihmuar një murg 80-vjeçar, Partheni, si më i vjetri atëbotë që e njihte dhe e zotëronte atë alfabet. Kështu, sipas tij:

“U desh një rast fatlum, që pikërisht gjatë qëndrimit tim në Elbasan erdhi tek unë për arsye shëndetsore një murg mbi 80 vjeç, me emrin Parthen, prej Manastrit të Shën Gjon

¹¹ Letër shoqëruese e natyrës testamentare, shkruar dhe firmosur prej Leopold Geitler-it më dt. 11 maj 1883 në Agram (sot Zagreb/Kroaci).

¹² Ndër studiues të mëvonshëm që i kanë përmendur ose botuar si faksimile, në mos edhe vatërzuar në lupën e filologut me transliterime e tejshkrime të posaçme, këto fragmente ose gjetje të reja dorëshkimore me alfabetin përkatës, dallojmë: Geitler 1883 39vv.; Nahtigal [1923] 2015b 90vv.; Shuteriqi 1959 175; Hetzer 1987 80vv.

Vladimirit, një orë larg Elbasanit. Ai duhej të ishte personi më i vjetër që shkruante shkrimin në fjalë, të cilin ai, siç kumtoi vetë, e kishte mësuar prej mësuesit të dikurshëm në Elbasan e më pas igumen i Manastirit të Vladimirit me emrin Camblak, një ish-nxënës i Theodhorit që mbahej sipas traditës popullore si dorëzanësi i atij shkrimi. Ky pasardhës i Theodhorit i kishte treguar atij gjithashtu, se Theodhori e kishte sajuar vetë atë shkrim dhe e kishte sjellë prej Voskopojës, kur studionte. Përndryshe ky shkrim sot po shkon drejt shuarjes. Ai u mënjaua (nga përdorimi) prej grafikës (= alfabetit) të Kristoforidhit, ndërsa sot është në përdorim ai i Frashërit (= alfabeti i Stambollit). Vetëm pak persona (disa tregtarë, edhe një grua¹³, prej së cilës unë disponoj specimina) e përdorin ende atë në korrespondencë; qarkullojnë edhe këngë kishtarë të shkruara me të. Deri para pak kohësh e mbarështonte atë edhe Pina; e përdorte edhe peshkopi i mëparshëm i Shqipërisë së Mesme.” (Pekmezi 1900 56-57)

Lidhur me sasinë e materialit shkrimor me këtë alfabet origjinal, Pekmezi shton në vazhdim:

“Partheni më tregoi ndërkohë që në manastirin e vet, në një valixhe te kori i Kishës, ku vendosen sende kishtarë të papërdorshme, ndodhen edhe libra e dorëshkrime, Ndër to mund të kishte ende diçka që ka të bëjë me Theodhorin, në rast se do të ishte po ashtu e drejtë, ngjarja e përshkruar prej Hahn-it, se shumica ishte djegur ndërkohë. Unë e ndoqa këtë kumt dhe gjeta në një valixhe të lënë tmerrësisht pas dore, më tej majtas në altarin anësor pranë fletësh pergameni greqisht edhe librash kishtarë vërtet edhe disa fletë dhe fletore të shkruara me shkrimin e Elbasanit, të cilat kishin të bënin me kohë të ndryshme, meqë ndër to ndodheshin madje edhe disa ligjërime të Pina-s.

Prej një kohe të mëhershme – veçse prej cilës (?), kjo është vështirë të thuhet – janë tri fletore me përmasat e atyre të Hahn-it, me nga 6 deri 20 fletë, të shkruara [me alfabetin origjinal] prej duarsh të ndryshme. Ndoshta shkon në kohë deri në shek. XVIII njëra syresh që përmban këngë fetare. Një e dytë tregon fabula në greqishte të vjetër me përkthim interlinear në greqishte të re dhe shqip. Në fund kjo ka të shkruara nga një

¹³ Bëhet fjalë këtu, pas gjase, për njërën ndër dy murgeshat e Manastirit të Shën Gjoni Vladimirit, si njohëset e fundit të alfabetit të Dhaskal Todhrit. (Shuteriqi 1954 *passim*; sh. edhe Nahtigal [1917] 2015a 41v)

tjetër dorë copëza teksti prej Testamentit të Ri. Edhe fletorja e tretë si edhe fletët e shprishura kishin të njëjtën përmbajtje. Veçse interesin më të madh lejon ta zgjojë një fletë quart me letër të trashë, tejet pis dhe e shqyer në mes, e cila përfaqëson në pamje të parë fragmentin më të hershëm. Pa dyshim duhet t'i takojë shek. XVIII dhe u njoh në një farë mënyre prej Parthen-it si e shkruar prej Theodhorit. Në qoshe të faqes së parme ajo bart numrin 55, në të prapmen 56; një dëshmi që ajo duhet t'i takojë një fletoreje tejet të vëllimshme, çka e bën të sqarueshme edhe përmbajtja: dy leksione apostolike prej letres së parë të Palit për Romakët. [...] Ndoshta nuk gabojmë, po të këqyrim këtu gjurmën e mbetur të një Apostolie, të destinuar për përdorimin kishtar, e cila si në përmbajtje ashtu edhe në kohë e ka burimin te Theodhori. Për këtë dëshmon edhe elbasanishtja e pastër e fletës – sepse ja ashtu –, Theodhori ishte anas në Elbasan.” (Pekmezi 1901 57-58)

Rrugëtimin e këtyre dorëshkrimeve të vëzhguara së pari, në mos edhe të marra me vete prej Pekmezit nuk jemi në gjendje ta ndjekim nga afër¹⁴. Pekmezi vetë botoi si shtojcë në raportin të tij dy faksimile: a) një fabulë të Ezopit në greqishten e vjetër që shoqërohej me përkthim interlinear në greqishte të re dhe shqip, dhe b) përkthimin shqip të një apostolie (1901 T I dhe II).

2.3 Fragmente dorëshkrimesh të mbledhura prej Lef Nosit (AQSH)

Një tjetër tog dorëshkrimesh me këtë alfabet që ndodhet sot i depozituar në Arkivin Qendror të Shtetit (AQSH, Tiranë) është, pas gjase, pjesë e trashëgimisë në dorëshkrim e atdhetarit Lef Nosi, e cila u sekuestrua menjëherë pas ekzekutimit të tij prej regjimit komunist (më 13 shkurt 1946) dhe u përcoll e tëra fillimisht në Arkivin e Institutit të atëhershëm të Shkencave e së fundi në AQSH. Ndër këto dorëshkrime feks një fragment prej Meshës së Shën Gjon Gojartit me format 19,5 x 14,5 cm (1 fl. e panum. + 21 fq. + 1 fq. bosh), kopjuar pas gjithë gjasash në shek. XIX prej murgut Haxhi Josifi i Haxhi Anastasit, igumen në Manastirin e përmendur të Shën Gjon Vladimirit. Ky fragment bëhet objekt shqyrtimi filologjik fillimisht në mënyrë të pjesshme prej Lef Nosit në disa numra të revistës “Kopështi Letrar” (nr. 1 deri 5 [1918]) e më pas – pas gjase i plotë – prej Dhimitër Shuteriqit (BSHSH (1 [1959]

¹⁴ Shih Nahtigal ([1917] 2015a 41) shkruan se “Gj. Pekmezi shkoi në Elbasan me urdhën të Akademisë së Shkencave të Vjenës dhe solli me vete disa fletë të shkrueme me këtë shkrim...”. Një gjurmë të çon pikërisht te trashëgimia postume në dorëshkrim e Rajko Nahtigal-it, i cili transliteroi dhe tejshkroi do fragmente prej materialit të mbledhur prej Pekmezit.

196-198) së bashku me material dorëshkrimor shtesë, ndër të tjera, edhe pesë fragmente ungjijsh: Jo V 1-14; Jo XII 17-50; Mat II 1-12; Mat XXVII 62-65 dhe Lu XVI, 19-31 etj. Në vazhdim, sipas tij:

“3. AQSH ruan fletë të ndryshme në dorëshkrim me alfabetin e Todhrit¹⁵, të cilat duhen vështruar me imtësi, në se janë përkthime të tij apo jo, sepse në Elbasan ka pasur edhe të tjerë që përkthyen librat kishtare dhe përdorën alfabetin e Dhaskalit. Në mes të atyre fletëve gjendet edhe një me përkthimin e dy fabulave të Ezopit, i ngjajshëm me atë që botoi në faksimile Pekmezi.

4. Më 1952, në AQSH hyri edhe një himn mbi Sh. Mërinë, kopje e vitit 1897, shumë e dëmtuar, pronar i fundit i së cilës ka qenë Lirak Dodbiba, në Tiranë.[...]” (Shuteriqi 1976 158v.)

2.4 Emri i Dhaskal Todhrit në bashkëlidhje me alfabetin origjinal?

Ndërsa mosha e gjithë këtij materiali dorëshkrimor, në shumësinë e vet, nuk zbret më poshtë se shek. XIX, për autorësinë e tyre ose së paku për dorëzaninë e alfabetit origjinal në to, është emri (gjerm.) <Teodor> me variantet shqip: <Theodhor, Thodhor, Thedhor, Theodor, Teodhor, Todhër>¹⁶, ai që vjen e bëhet gjithnjë e më i njohur në studimet shqiptare, madje sidomos në formën e traditës popullore si Dhaskal Todhri (= Mësues Todhri: § 2.3). Bëhet fjalë këtu për Theodhor Filipin ase Haxhifilipin, më saktë Theodhorin e Haxhi Filipit si mësues dhe predikues i njohur në Elbasan në gjysmën e dytë të shek. XVIII e njëkohësisht si pinjoll i një familjeje argjendarësh. Këtë zanat duhet të ketë pasë ushtruar edhe Dhaskal Todhri në rini të vet, meqë edhe rroga e mësuesit atëbotë ishte minimale.

Për këto të dhëna biografike, sado të brishta, u jemi mirënjohës dy studiuesve elbasanas: Lef Nosi (1918) dhe Dhimitër Shuteriqi (1949; 1954)¹⁷. Shuteriqi (1976 156) na kumton gjithashtu se Dhaskal Todhri

¹⁵ Për këtë fond dhe fragmentin në fjalë si pronësi e Lef Nosit sinjalizon së pari Nahtigal [1923] 2015b 74.

¹⁶ Shih Nahtigal [1923] 2015b 71, sipas të cilit: “Emrin *Todhër* e kam dëgjuar ashtu në Elbasan; përndryshe katolikët gegë e quajnë *Teodori*, ndërsa ortodoksët, para së gjithash toskët e quajnë *Theodhori*, *Thodhori*, *Thedhori*. (Khs. Kalendari i Shoqërisë “Dija” për vjetin 1906 dhe Kalendari Kombiar 1908 (Sofje) 1908)”.

¹⁷ Pjesë e kujtesës kolektive, që në shumë raste mbetet e tillë, përkatësisht e pavërtetuar me dokumentacion bashkëkohor janë: a) emri dhe nami i mirë i Dhaskal Todhrit si njeri letrash dhe diturak në qytet; b) që shkollën fillore (greqisht) e kreu në vendlindje, ndërsa formimin fetar dhe humanist-intelektual e kreu në akademinë e njohur të Voskopojës me mësues Grigorin (e Durrësit) dhe Kavaliotin; c) që pati një jetë martesore fare të shkurtër e me një fëmijë që nuk rroi gjatë; d) që në moshë pas gjase të vonuar erdhi e u dorëzua prift; e) që në fillim të shek. XIX shkoi në Rusi (?) për të derdhur shkronjat e alfabetit të vet, përkatësisht

do të jetë lindur aty rreth vitit 1730, pasi ka qëmtuar së pari emrin e tij si firmëtar në kodikun e argjendarëve të qytetit me emrin e parmë "Theodhor" në vitin 1750. Po ashtu, duke ndjekur dokumentacionin e kodikëve të qytetit dhe sosh të Manastirit në Shijon, Shuteriqi fikson motin e vdekjes së Dhaskal Todhrit afërsisht më 1805¹⁸.

2.5 Përfundime paraprahe

Nga sa parashtroam në paragrafët më sipër të kësaj rubrike, lejohemi të përmbledhim thukët, se materialet e dorëshkruara me këtë alfabet origjinal, pas gjase, i takojnë në tërësinë e tyre – qoftë edhe me ndonjë përjashtim të rastit (§ 2.2)¹⁹ – shek. XIX, bash në një periudhë kur ai zotërohej dhe praktikohej prej një numri sado të kufizuar klerikësh, tregtarësh elbasanas deri edhe banorësh të shtresave të caktuara sociale (ortodokse) të qytetit. Në kujtesën kolektive kjo traditë shkrimi i vishej një mësuesi dhe predikuesi elbasanas me formim të patëmetë teologjik-intelektual, së paku, në akademinë e dikurshme të Voskopojës. Ai thirrej atëbotë me emrin e parmë (gjerm.) Teodor (= shq. Todhër, Thodhër, Theodhor, Theodor, Teodhor), bash ashtu siç e kishin dëgjuar dikur qoftë Hahn-i më 1849, qoftë Pekmezi më 1900, ndërsa në traditën qytetare elbasanase personaliteti i tij gjëllinte i fiksuar më fort në bashkëlidhje me ofiqin Dhaskal Todhri. Hollësi të mëtejshme edhe mbi (mbi)emrin Theodhor Filipi si Theodhori i Haxhi Filipit dhe Theodhor Haxhifilipi i mësojmë më vonë, ndër të tjera, në një material në dorëshkrim të Kristoforidhit (sh. Lloshi 1989 162), në shkrimet e Nosit (1918), të Nahtigal-it ([1923] 2015a/b) e sidomos në ato të Shuteriqit (1949; 1954; 1976). Asgjëmangut studimet e derisotme nuk kanë mundur ende të izolojnë deri sot si të sigurt qoftë edhe një fragment sado të shkurtër, që të paskësh qenë fiksuar dikur në letër me dorën dhe pendën e Dhaskal Todhrit d.v.

Parë nga përmasat e materialit dorëshkrimor që ka qarkulluar deri sot në duart e studiuesve, njehim me afërsi një sasi modeste faqesh që

për të ngritur një shtypshkronjë për libra shqip në Elbasan ose Voskopojë (?); f) që gjatë rrugës në kthim, diku pranë fshatit Xhyrë u vra në mos prej kishës greke, së paku prej qiraxhinjve vllahë, të cilët i morën dengjet e rënda me shkronjat e derdhura si të mbushura me pasuri etj. (Shuteriqi 1949 51vv; 1954 35vv.)

¹⁸ Në AQSH ruhet në fakt edhe një akt juridik greqisht i hartuar dhe firmosur më 25 tetor 1770, pas gjase po prej Dhaskal Todhrit e që ka të bëjë me birësimin e një fëmije të mbetur jetim: AQSH Koleksion Fondesh Personale; Theodhor Haxhifilipi (Dhaskal Todhri) D 210 (25.10.1770): Akt i vendosjes së kujdestarisë ndaj një jetimi, nënshkruar nga Theodhor Haxhifilipi (Dhaskal Todhri). Detaje të shumta për jetën e Todhrit dhe të familjes së tij përcjell Shuteriqi 1954 35vv.

¹⁹ Sipas Shuteriqit (1949 49) shkrimet më të hershme të shkruara me këtë alfabet datojnë vitet 1797-98 në kodikun e tregtarëve elbasanas të familjes Popa.

vështirë të kapërcejë shifrën 130 deri 150. Pjesa më e madhe dhe më e vjetër e këtij materiali rezulton të ketë rrugëtuar deri në vitin 1900 në drejtim të Vjenës: pjesërisht në ÖNB (46 f.) si trashëgimi postume e Johan Georg von Hahn-it e pjesërisht në pronësi (sado të përkohshme) të Gjergj Pekmezit (aty tek 40-50 f.) e që duhet kërkuar²⁰. Fondi i tretë me material dorëshkrimor, që dispononte dikur Lef Nosi në bibliotekën e tij private, ruhet sot e gjithë ditën në Tiranë në AQSH (rreth 30-50 f. ?) dhe pritet t'i nënshtrohet përpunimit dhe klasifikimit më të detajuar dokumentar-arkivor.

Ndërsa njohja e thelluar, studimi filologjik dhe edicioni i mirëfilltë kritik i këtij materiali nuk është rrokur në tërësinë e vet në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip, për kodin alfabetik origjinal të zbatuar në to është shkruar herë pas here e rast pas rasti, sidomos në Perëndim (Hahn, Geitler, Pekmezi, Nahtigal, Hetzer, Elsie). Nismëtar për studime të mirëfillta epigrafike ishte shi themeluesi i albanologjisë si shkencë komplekse rajonale në shek. XIX, Johann Georg von Hahn d.v. (1849, 1850, 1854); andaj le t'i përkushtohemi në vijim rezultateve të studimit të tij mbi këtë kod, lidhur me burimin dhe sfondin kulturor-historik të përdorimit të tij.

3. Alfabeti i Dhaskal Todhrit në fokusin e gjyimeve të Hahn-it

Bashkëlidhja e alfabetit origjinal me emrin e Dhaskal Todhrit e bën atë së paku më të hershëm se vetë materialet e shkruara me të, ashtu siç i njohim deri sot. Kjo rrethanë e nxiti, pas gjase, Hahn-in si „zbuluesin (e tij) zyrtar“ që të merrej konkretisht edhe me studimin e këtij alfabeti, duke i kushtuar vëmendje përshkrimit, përhapjes e sidomos historisë, përkatësisht rrugëve të përfuturit të tij.

Ndryshe nga ajo përshtypje e parë që i la një alfabet i dytë origjinal, pikërisht ai gjirokastrit i Veso Beut (§4.3.1), studimi i thelluar i alfabetit elbasanas të Dhaskal Todhrit e joshi Hahn-in të vinte në përfundimin, se ky nuk mund të ishte assesi një sajese arbitrare e një individi e që këtej të kishim të bënim thjesht me një rastësi, sa i përket ngjashmërisë së tij (të dukshme) me alfabetin e stërlashtë fenikas, sikurse me atë protogreqisht, në kuptimin që edhe ky i fundit, sikurse ai elbasanas pritej të kishin buruar në instancë të fundit prej gjegjësit fenikas. Këtë përjasje Hahn-i e konsideroi qysh në fillim si të mirëqenë, andaj, krahas paraqitjes dhe përshkrimit të alfabetit elbasanas, ai u rrek të ndriçojë edhe rrugëtimin e shenjave dhe të karaktereve grafike në kod prej njërit alfabet në tjetrin.

Le të ndalemi në vijim në veçanti për secilën pamje:

²⁰ Shih shën. 14.

3.1 Inventari i shkronjave, emërtimi dhe vlera e tyre tingullore

Tabela e mëposhtme pasqyron inventarin e shenjave grafike (shkronjave, grafemave) që ngërthejnë së bashku kodin alfabetik të zbatuar në shkrimin origjinal të Dhaskal Todhrit. Si mjet ndihmës në realizimin e saj, Hahn-it i ka shërbyer, pas gjase, renditja e tyre në dy faqe të materialit të mbledhur prej tij, ndër të cilat, vetëm njëra është e numëruar me shifrën 15. Për emërtimin e secilës shenjë në veçanti dhe fiksimin e vlerave fonetike përkatëse mund a duhet ta ketë ndihmuar padyshim një njohës i alfabetit në terren²¹, pa dashur assesi të rrudhim këtu produktin e punës së tij të centë me fragmentet e teksteve në dorëshkrim, si vijon:

Nr.	Zeichen.	Benennung.	Werth.	Nr.	Zeichen.	Benennung.	Werth.	Nr.	Zeichen.	Benennung.	Werth.
1.	V	A	a	19.	ʃ	Ra	r	37.	ʒ	θa	griech. θ
2.	I	E	ata e	20.	f	Rra	rr	38.	ʋ	Ba	b
3.	I	I	i	21.	ʒ	Fa	f	39.	ʋ	Mba	mb
4.	O	O	o	22.	ʋʋ	Δa	griech. δ	40.	ʋ	Pa	p
5.	ō	U	u	23.	ʒ	Ma	m	41.	v	Na	n
6.	ʋ	Ū	ū	24.	ʋ	Ja	griech. j	42.	q	Tscha	tsch
7.	ʋʋ	E	stamm e	25.	h	Gha	gh	43.	g	Dscha	dsch
8.	z	Sa	s	26.	k	Ngha	ng	44.	gʷ	Ndscha	nds
9.	ʋ	Ca	griech. c	27.	ʋ	Gja	gj	45.	5	Sta	st
10.	ʋ	Tsa	ts	28.	ʋ	Ngja	ngj	46.	ʋ	Scha	sch
11.	ʋ	Dsa	ds	29.	ʋ	Ia	griech. γ	47.	ʋ	Ja	trasm. j
12.	ʋ	Ndsa	nds	30.	ʋ	Pa	ps	48.	ʋ	Schta	sch
13.	ʋ	Wa	w	31.	ʋ	Ha	h	49.	ʋ	Ts	ts
14.	H	La	l	32.	X	Cha	griech. ch	50.	ʋ	Njan	nj
15.	q	Lja	lj	33.	ʋ	Chja	griech. ch	51.	ʋ	As	as
16.	ʋ	Kja	kj	34.	ʋ	Ta	t	52.	ʋ	Ω	griech. ω
17.	ʋ	Ka	k	35.	ʋ	Da	d				
18.	ʋ	Xan	x	36.	ʋ	Nda	nd				

Tabela 1: Alfabeti i Dhaskal Todhrit (Hahn AS I, 1954 280)²²

²¹ Sh. më lart (§ 2.1), ku citojmë Hahn-in (1849 6) duke pohuar: "...Gjeta jo vetëm ABC-në, por edhe një dorëshkrim të shkruar me të, një përkthim të homilive greke që vështirë se mund të jetë më i vjetër se 50 vjet, sepse personi që e ka shkruar këtë në rininë e vet, jeton ende."

²² Hahn-i e përcjell këtë klasifikim në një tabelë të ngjashme katër vjet më parë (1850 1).

Nga kjo tabelë vërejmë se inventari i shkronjave të alfabetit në fjalë arrin shifrën 52, duke u radhitur vertikalisht në tri blloqe me nga katër kolona secili: nga e majta në të djathtë (1) numri rendor; (2) shenja apo shkronja ase grafema; (3) emërtimi dhe (4) vlera fonetike ose shqiptimi.

Ndër 52 shkronjat e renditura, 37 Hahn-i i klasifikon si të thjeshta, ndërsa 15 syresh përbëjnë grupin e të ashtuquajturave shenja (shkronja) dyshe, të cilat përkojnë ose me nyjetimin e një togu tingujsh, ose janë përjetuar si të tilla në ndërgjegjen gjuhësore të shpikësit nativ të atij alfabeti, si psh.: *nd, ng, ngj, mb, st, sht, ps, ks, nc, nx* krahas *nj* [n+j], *zh* [ʃ+] etj. Duke i mënjanuar këto 15 shenja nga inventari i përgjithshëm, 37 shenjat e ashtuquajtura të thjeshta Hahni i ndan më tej në dy grupe: 8 zanore dhe 29 bashkëtingëllore.

Në këtë pamje të përgjithshme tabelare kemi një farë shmangieje në timbër lidhur me inventarin e sotëm të fonemave zanore. E kjo ka të bëjë me shenjën grafike të zanores *o* të gjatë (nr. 52), e cila ngjason me *omega-n* greqisht, e që sipas Hahn-it, shfaqet kryesisht, më saktë vetëm në funksionin semantik-leksikor të një pasthirrme. Përndryshe, në inventarin e shkronjave bashkëtingëllore, i cili, pas gjithë gjasash, nuk përkon patjetër me 29 fonemat bashkëtingëllore të shqipes standarde, vështirësitë e klasifikimit janë më të ndërlikuara, meqenëse të ashtuquajturat shenja (grafema) dyshe nuk përkojnë gjithherë me togje bashkëtingëlloresh e si të tilla kërkojnë një shqyrtim më të detajuar që i kapërcen kufijtë modestë të këtij shkrimi.

3.2 Realizimi i shenjave grafike në kod

Klasifikimi i inventarit shkronjave në të thjeshta dhe dyshe përbën në të njëjtën kohë edhe atë ndërhyrje të parë të Hahn-it në autopsinë që ndërmerr ndaj alfabetit elbasanas, bash kur ai – i joshur prej asaj ngjashmërie jorastësore, që vjen me thënë më se të dukshme mes këtij alfabeti dhe atij fenikas, e sado ndërmjetshëm edhe me gjegjësin protogreqisht (§ 3) – rreket të trajtojë edhe çështjen e burimit të tij, pra, nëse kemi të bëjmë këtu me një trashëgimi të drejtpërdrejtë prej periudhave të kryehershme të antikitetit ballkanik, apo thjesht me një produkt të një individi me dije intelektuale të spikatura në gjysmën e dytë të shek. XVIII (sh. §4.1).

Parë nga kjo perspektivë, Hahn-i dallon sidomos shenjat dyshe si gjetje të qëlluara të një “reformuesi” të spikatur (Dhaskal Todhri ?). Përndryshe shkronjat e thjeshta u përkasin, sipas tij, përgjithësisht periudhave të kryehershme të antikitetit ballkanik e si të tilla evokojnë ndërhyrje të atyre njohësve, më saktë folësve nativë që ranë në kontakt së pari me shkrimin fenikas, duke e përshtatur atë për shkrimin e protoshqipes.

§ 3.2.1 Realizimi i shkronjave dyshe

Në rast se marrim tash në analizë realizimin e shenjave grafike dyshe, të cilat mund t'i quajmë ndryshe edhe 'ligatura', vërejmë se përsiatjet e Hahn-it janë bindëse, në kuptimin që interpretimet e tij për ngjizjen e një numri syresh janë mbushamendëse. Të tilla janë p.sh. do togje bashkëtingëllore me emërtimet gjerm. *nda* : /n+d/; *mba* : /m+b/; *sta* : /s+t/; *shta* (= shq. *shta*) : /sh+t/; *tscha* (= shq. *ça*) : /t+sh/; *ndsä* : /n+x/; *ngha* : /n+g/; *psa* : /p+s/ etj., më tej do bashkëlidhje të qëndrueshme V+C dhe C+V, khs.: *as* : /a+s/ dhe *te* (= shq. *të*) : /t+ë/ etj., si vijon:

$$\mathbb{N} (: /n+d/) = \mathbb{V} (: /n/) + \mathbb{A} (: /d/)$$

$$\mathbb{B} (: /k+s/) = \mathbb{C} (: /k/) + \mathbb{S} (: /s/)$$

$$\mathbb{X} (: /sh+t/) = \mathbb{X} (: /sh/) + \mathbb{T} (: /t/)$$

$$\mathbb{V} (: /t+ë/) = \mathbb{T} (: /t/) + \mathbb{E} (: /ë/)$$

etj.

Siç përmendëm më lart (§3.1), ndër shenjat dyshe nuk mungojnë as raste që në ndërgjegjen e sotme gjuhësore perceptohen si fonema të veçanta, khs.:

$$\mathbb{N} (: /nj/ = /n+j/) = \mathbb{V} (: /n/) + \mathbb{J} (: /j/)$$

$$\mathbb{X} (: /zh/ = /sh+j/) = \mathbb{X} (: /sh/) + \mathbb{J} (: /j/)$$

$$\mathbb{G} (: /xh/ = /d+sh/) = \mathbb{A} (: /d/) + \mathbb{X} (sh/) \text{ (të kthyera përmbys)}$$

etj.

Po në këtë grup grafemash dyshe Hahn-i ngërthen edhe togje bashkëtingëllore që paraqiten grafikisht me një shenjë të thjeshtë dhe një shenjë dyshe në vetvete, khs.:

$$\mathbb{G} (: /n+xh/) = \mathbb{V} (: /n/) + \mathbb{G} (: /xh/)$$

§ 3.2.2 Realizimi i shkronjave të thjeshta

Në përjasje me shkronjat dyshe (15) shkronjat e ashtuquajtura të thjeshta përbëjnë shumicën në numër (37). Për sqarimin e burimit e të realizimit të tyre grafik Hahn-i përdor një tabelë të dytë, duke i ballafaquar sipas rastit me gjegjëse fenikase dhe protogreqishte, si më poshtë:


Phöniciſch.	Albanesiſch.	Urgriechiſch.
1. Aleph א	1. v	Α
2. Beth ב	2. ʾ	Β
3. Gimel ג	3. γ	Γ
4. Daleth ד	4. δ	Δ
5. He ה	5. ʔ ſtumm e	Ε
6. Vau ו	6. ʔ ū	Υ Franz s. 25 s §. 3, §. 4, Nr. 2.
7. Sain ז	7. ʔ ds ?	Η
8. Chet ח	8. ʔ ts ?	Θ
9. Tet ט	s. Nr. 9.	⊗
10. Jed י	s. Nr. 20.	⋄
	s. Nr. 31.	
11. Kaph כ	9. h gh	
{ ʔ hierat. q	10. ʔ ghj	Κ
{ ʔ puniſch ʔ	11. x kj s. Nr. 21.	
12. Lamed ל	12. Η	Τ
13. Mem מ	s. Nr. 35.	Μ
14. Nun נ	13. ν	Ν
	14. ʔ r	
15. Samech ס	15. z	Ζ ζ s. §. 6, Nr. 22
16. Ain ע	16. o	Ο
17. Phe פ	17. ʔ w	Ϝ s. §. 5, Nr. 17.
18. Zade צ	18. ʔ f	
19. Koph ק	19. ʔ griech. ζ	
	20. ʔ griech. ʔ	Ϙ
	21. ʔ frauz. j s. Nr. 11	
20. Reſch ר	22. ʔ rr	Α Ϝ s. §. 5, Nr. 19.
21. Shin ש	23. ʔ sch	Μ
22. Tau ת		
aramäiſch ט	24. ʔ	Τ Η s. §. 6, Nr. 28.
23. Gaiu ך	25. c k	Ϛ
puniſch ʔ	26. ʔ deutſch j	
24. Ya? יא	27. ʔ ch hell	
	28. e h	β s. §. 6, Nr. 25.
puniſch י	29. ʔ ū	Δ
kalybiſch י	30. ʔ d	Ι
pke phönic., ʔ in- diſch, ʔ W. Grotten.	31. i i	Ϛ
sanscrit ʔ r, kufiſch. ʔ m	32. u p	Ϛ ?
etruriſch ʔ f	33. ʔ	Χ
kirylliſch ʔ tſch	34. x dunkel ch	
	35. ʔ m	
	36. s x	
	37. q	

Tabela 2: Përqasje e shenjave të thjeshta grafike (Hahn 1850 16v.)

Tabela e mësipërme pasqyron në një mënyrë a një tjetër rezultatet e studimit të Hahn-it, pasi ka përqasur në mënyrë sistematike alfabetet në fjalë, duke syzuar nga njëra anë marrëdhënie ndërvarësie të pandërmjetme midis alfabetit shqip prej atij fenikas e nga ana tjetër rrugët paralele të përfutimit të tij në përqasje me atë protogreqisht. Asgjëmangut, sistematika në studim sendërtohet me gjithë-gjithë katër rrugë përfutimi të shenjave të thjeshta grafike për alfabetin shqip, ndër të cilat tri e bashkëlidhin natyrshëm burimin e tyre me alfabetin fenikas dhe vetëm një syresh dëshmon burime alfabetesh të tjera. Kjo rrugë e katërt kushtëzohet, sipas Hahn-it, prej numrit të kufizuar prej 24 shenjash grafike që bart alfabeti fenikas në vetvete, përkatësisht prej inventarit shumë më të madh të tingujve me funksion kuptimvallues që kemi në gjuhën shqipe me plot 37 syresh.

Prashtu, lidhur me shndërrimin e shenjave të alfabetit fenikas në funksion të gjegjëseve shqip, Hahn-i (1854 281-286) përsiat sipas rastit:

- a) Shkronja të përfutara me 'lëvizje rrethore' në qendër të bazës burimore fenikase. Kjo lëvizje shkon sipas rastit $\frac{1}{4}$, $\frac{1}{2}$, $\frac{3}{4}$ në të njëjtin drejtim ose në atë të kundërt me akrepat e orës. Grafika e mëposhtme, e realizuar prej Hahn-it d.v. (1850 7) dëshmon lëvizjen rrethore në të kundërt me akrepat e orës gjatë përfutimit të shkronjës <a> në alfabetin shqip dhe protogreqisht prej gjegjësit fenikas:



Në këtë kategori Hahn-i përcjell një numër të konsiderueshëm shkronjash të alfabetit shqip, ndër të tjera: (me vlerat funksionale shq.) *a, b, d, dh, g, gh, h, k, j, m, n, p, q, th, y, z*.

- b) Shkronja të përfutara nëpërmjet 'përthyerjes' nga e djathta në të majtë ose anasjelltas: Në këtë kategori bëjnë pjesë, sipas Hahn-it, ndër të tjera: (shq.) *f, rr, v*.
- c) Shkronja të marra *en bloc* pa ndryshim pozicioni, që vjen me thënë 'kopjime': (α) qoftë prej alfabetit fenikas; (β) qoftë prej ndonjë alfabeti tjetër (punik, kabyl, indas, etrusk, protogreqisht etj.), si psh.: *c, ç, ë, ç, l, ll, r, s, sh, t, x, zh, ks, ω*.²³

²³ Gjithsej 34 shkronja. Tri shkronja Hahn-i i lë pa trajtuar.

4. Kronologji dhe gjeografi kulturore-historike e alfabetit shqip

Pas analizave të mirëfillta të natyrës epigrafike e grafematike, Hahn-i i rikthehet pyetjes që shoqëron në çdo hap studimin e tij: Ç'moshë ka alfabeti elbasanas (i Dhaskal Todhrit); a është ai i kryehershëm (mijëvjeçari i dytë p.e.s.) apo i një moshë të vonë (fundi i shek. XVIII)? Në rubrika të veçanta Hahn-i rreket të qëmtojë dhe gjykojë arsyet që mbështesin potencialisht njëren ose tjetrën zgjidhje alternative (1850 21vv.; 1854 292vv.: § 12).

4.1 Moshë e re e alfabetit original shqip (?)

Prashtu, për një zgjidhje në dukje të natyrshme, sipas së cilës ky alfabet qenkësh krijuar ashtu siç mëtohej në kujtesën kolektive elbasanase në gjysmën e dytë të shek. XVIII, pikërisht prej <Teodor-it> (= Dhaskal Todhrit) si dijetar erudit nativ, Hahn-i përcjell vetë në diskurs një dorë argumentesh pozitive, ndër të cilat dallojmë si më të spikaturat:

1. Do vite më parë (1844 – BD) ishte një shqiptar, me (mbi)emrin Bythakuqe²⁴, që u rrek të realizonte një alfabet origjinal, pa pasur dijeni për alfabetin ekzistues.
2. Prija e shqiptarëve bashkëkohës për të korresponduar me shifra: khs. alfabetin gjirokastrit të Veso Beut.
3. Vështirësia në konceptim deri në pamundësi reale që një radhojë shkronjash – përgjatë një tradite shkrimore 3000 vjeçare, pra prej së paku 90 brezash – të ketë ruajtur konturet e veta me një qartësi të tillë, saqë sot e gjithë ditën ato në shumësinë e tyre arrijnë të dallohen lehtësisht prej trajtave burimore.
4. Sajimi i përsosur i alfabetit për përdorim bashkëkohor, në kuptimin që ai vetë nuk dëshmon asnjë lloj arkaizmi, përjashtojë vetëm shkronjat dyshe. Përndryshe, thuajse asnjë shenjë nuk dëshmon të jetë, sipas tij, e panevojshme për shkrimin e shqipes bashkëkohore, domethënë ashtu siç nyjëtohej ajo aktualisht (në vitet 50' të shek. XIX).

Duke ecur në këtë hulli, Hahn-i skicon edhe një numër argumentesh të natyrës negative, në kuptimin sosh që përjashtojnë moshën e re të këtij alfabeti, përkatësisht mundësinë e përfuturit të këtij alfabeti si konstrukt i dhaskalit elbasanas me emrin <Teodor> në fund të shek. XVIII. Kështu, sipas Hahn-it:

1. Autori i alfabetit shqip mund të kishte shpërfillur të gjitha alfabetet

²⁴ Në botimin e parë (Hahn 1850 21) llagapi i vendlindjes së Naum Veqilharxhit shkruhet gabim si /Hundëkuqe/.

e gjuhëve fqinjë, duke iu përkushtuar vetëm atij fenikas antik, i cili nuk ishte i panjohur gjatë mesjetës dhe kohës së re. Këtë përsiatje Hahn-i e kundërshton po vetë (1854 293, shën. 1), duke shtuar se cikli i formimit bizantin-kishtar i (Dhaskal) Todhrit nuk i rrokte gjuhët semite me kulturën përkatëse. Dhe ajo **çka njihej në** formimin e tij intelektual-fetar ishte thjesht ndjekja me sukses e studimeve në Akademinë e Voskopojës.

2. Po ashtu autori i alfabetit shqip mund t'ia kishte dalë mbanë të sajonte po vetë grafi të tilla të sakta që përkojnë me gjetjet dhe hulumtimet shkencore më të fundit në Perëndimin e shek. XVIII-XIX. Por edhe ky kontakt, sipas Hahn-it, mungonte atëbotë për këtë autor.
3. Më tej, ky autor, sipas rregullsive, të fiksuara po prej tij, mund të kishte shndërruar në mënyrë sistematike bazën e një pjese të shenjave burimore, duke i përthyer dhe/ose rrotulluar ato, në kuptimin që këto metoda nuk parakuptonin patjetër një moshë tejet të hershme.
4. Në tërësi, autori i alfabetit shqip do t'u mbetej tejet besnik trajtave burimore dhe vetëm në mënyrë përjashtimore do t'u kishte veshur trajtave fenikase timbrin e tingujve të tjerë.
5. Pasi të kishte përpunuar në këtë mënyrë fondin fenikas, autori do të vërente se ky fond nuk i mjaftonte për të pasqyruar në shkrim larminë tingullore (= fonematike) të gjuhës së vet. Andaj do t'i kishte plotësuar këto zbrazëti me shkronja të huazuara prej inventarit të gjuhëve të tjera, të barasvlershme në kohë me alfabetin fenikas, por që ishin bërë të njohura në Perëndim vetëm kohët e fundit (shek. XVIII-XIX).
6. Autori i alfabetit shqip do të mund të kishte shpërfillur së fundi edhe ndonjë shenjë protogreqisht deri edhe sosh fenikase, duke parapëlqyer kështu gjegjëse përkatëse në alfabetin indas (p.sh. *m*), madje deri sish të përdorura në Amerikën e Mesme (për *d* dhe *l*) e në protogreqishte (*ō*) etj.
7. Sipas Hahn-it, e njëjta procedurë vërehet së fundi edhe në mënyrën e ngjizjes së shenjave grafike dyshe.

Parë nga kjo perspektivë, shumëkush do të mund të gjykonte se autori i alfabetit shqip pritej së fundi të ishte një erudit shqiptar i periudhës së Mesjetës ose i Kohës së Re. Veçse vënia e shenjës së barazimit ndërmjet tij dhe Dhaskal Todhrit nuk do t'i përgjigjej assesi realitetit kulturor-intelektual të kësaj periudhe, sepse nuk përkon aspak me formimin e tij heleno-bizantin në Akademinë e Voskopojës.

4.2 Në kërkim të gjurmëve parahistorike të alfabetit

Pas kësaj paraqitjeje sistematike të analizës historike-epigrafike për alfabetin në tërësinë e tij, sikurse për secilën shkronjë në veçanti, Hahn-i (1854 288) vjen në disa përfundime, në dukje të natyrshme. Sipas tij:

1. Alfabeti i protoshqipes (=elbasanas) sikurse edhe ai i protogreqishtes janë përfutur paralelisht dhe si të tilla pandërmjetëm prej alfabetit fenikas.
2. Alfabeti i shqipes bashkëlidhet gjithsesi më ngushtë me atë fenikas në përqasje me gjejësin protogreqisht.
3. Në alfabetin protogreqisht gjëllin shenja grafike, të cilat shfaqen vetëm në ato faza tejet të hershme, por në rrjedhë të kohës kanë dalë jashtë përdorimit në kulturën e shkrimit grek, ndër to: α , β , l , r , s , x , p .
4. Alfabeti elbasanas ngjason gjithnjë e më pak me variacionin e mëvonshëm të alfabeve të greqishtes klasike dhe të së resë.
5. Alfabeti i shqipes përshtatet plotësisht me alfabetin fenikas dhe me sosh të afërt me të (§3.2.2.2c β), çka vjen me thënë, se ndër 52 shenjat (shkronjat) e alfabetit të shqipes shumica e tyre nuk mbetet jashtë bashkëlidhjes së pandërmjetme me të e me alfabe bashkëkohore të asaj periudhe. Për rrjedhojë edhe ky alfabet i takon, sipas Hahn-it së njëjtës familje.

e duke shtuar së fundi, se:

“Vetëm këto rezultate të dukshme mundën ta nxisnin autorin me pranëvënë ungji këtë alfabet të gjallë (= bashkëkohor) me shkrimet lapidare të popujve antikë, pa mbajtur parasysh këtu shkençën e (studimit të) dorëshkrimeve. – Andaj, sigurisht që vëzhgimet e mësipërme e me do zbrazëti të rastit do të mund të plotësohen dhe përmirësohen prej kësaj shkence...”²⁵

Përsiatje të kësaj natyre i hapin udhë natyrshëm Hahn-it me e ngërthyer kulturën e shkrimit shqip si pjesë përbërëse e matrisit të kulturës etnike shqiptare qysh para dyndjeve greke në Ballkan, bash në një periudhë:

²⁵ Përpos këtyre përfundimeve, Hahn-i (1850 289vv.) vijon në tri rubrika ndjekëse: (§ 8) sistematizimin e (një pjese të) inventarit të shkronjave shqip në (1) “Stumme Laute” (tabelë) = tinguj (?) të zhurmët: k , gh , g , j , h , p , b , f , t , d , etj.), (2) “Flüssige Laute” = tinguj sonantë: m , n , r , rr , l , ll ; (3) “S-Laute” = tinguj (?) spirantë: s , z , sh , zh , th , dh , $ç$, xh , c , x ; (4) “Vokale” = zanore: shtatë zanoret e shqipes të dallueshme në timbër, së bashku me një zanore hundore, që Hahn-i e përqas me gjerm. / $\ddot{o}$ / si zanore e përparme e ngritjes së mesme të lartë, e cila shfaqet, sipas tij, në shqipe sidomos në fjalë një rrokëshe me rrokje të hapur, khs.: shq.-st. gje = (dial. Elbas.) [j $\ddot{o}$], shq.-st. fje = (dial. Elbas.) [fr $\ddot{o}$] etj.; (§ 9) “Renditja dhe emri/emërtimi i shkronjave” dhe (§ 10) “Mbi shenjën e shkruar si < $\wedge$ >.”

“Kur gadishulli ishte i banuar nga pellazgët, të cilët ishin të parët në Hellas që fenikasit ua sollën atë alfabet prej trojeve të veta. Më vonë u mbivendosën aty helenët që përthithën dhe përshtatën në pikëpamje gjuhësore elementin pellazg, duke marrë prej tij ndër të tjera edhe shkrimin që buronte prej fenikasve, i cili tashmë, në bashkëvajtje me proceset e arsimimit, iu nënshtrua një cikli të plotë zhvillimi, duke u përsosur në format më fisnike; veçse kur arriti një pikë kulmore, nisi të birrej njëlloj si edhe arti i tyre në përgjithësi.

Në pjesë të tjera të gadishullit, në të cilat elementet pellazge nuk përjetuan një mbishtresë helene e për këtë arsye edhe ashpërsia e dikurshme shpirtërore vijoi të gjëllinte pa ndërprerë, u ruajtën aty edhe marrëdhëniet fisnore, hakmarrja, dhe e drejta e grushtit (e të fortit) me një pandryshueshmëri të ngurosur, andaj e përcjell atë (alfabetin) si dëshmi e qartë e gurrës, prej së cilës buronte, anipse ndërmjet saj dhe sot jetin mijëra vjet.” (Hahn 1854 295)

4.3 Recepsioni i tezës pellazgjike të Hahn-it në kulturën e shkrimit shqip

Autoriteti i Hahn-it si njohës dhe studiues i patëmetë fushën e paleoetnologjisë së Ballkanit antik, në atë të kulturës antike helene sikurse edhe i studimeve shqiptare në përgjithësi nxitën interesimin e rretheve shkencore-intelektuale të kohës. Prashtu nuk bëjmë çudi, përse paraqitja tabelare e alfabetit elbasanas (të Dhaskal Todhrit) dhe e atij gjirokastrit (të Veso Beut) u rrokën në doracakët enciklopedikë të kulturës së shkrimit në Ballkan, në pellgun e Mesdheut dhe në Europë në përgjithësi (Faulmann 1880 181v.²⁶), ndërkohë që vetë alfabeti si i tillë vërehej si urë lidhëse në rrjetin e shkrimeve të antikitetit të hershëm e të vonë, duke i caktuar deri edhe pozicionin e zanafillës në burimin e alfabetit glagolik (Geitler 1883 65vv.). Frymëzime të rastit përjetoi kjo tezë në rrethet e ndryshme intelektuale shqiptare, sidomos gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare e më tej deri në vitet 30’ të shekullit të kaluar, kur prejardhja pellazge e popullit shqiptarë dhe e gjuhës së tij u bënë pjesë e programit ideologjik kombëtar.

Po të përqendrohemi në vijim të studimit tonë vetëm në çështje të përhapjes dhe të burimit të këtij alfabetit, padyshim që nuk mund t’i anashkalojmë kritikës së mirëfilltë së derisotme shkencore, sado të brishtë, lidhur me këtë tezë, përkatësisht me bazën empirike të rezultateve, që mbështesin argumentet pozitive ndaj saj.

²⁶ Për konsultime të mëhershme shih Nahtigal [1923] 2015b 61vv.

4.3.1 Trojet historike të alfabetit të Dhaskal Todhrit

Ndryshe nga përfundimet që Hahn-i ia lejon vetes falë analizave induktive dhe deduktive qoftë të karaktereve grafike të veçanta, ashtu edhe të vetë alfabetit shqip në përgjithësi, të dhënat historike që disponojmë lidhur me përhapjen dhe përdorimin e tij na dëshmojnë tjetër pamje. Prashtu, siç përmendëm thukët më lart në rubrikat hyrëse të këtij studimi (§§ 1, 2-2.3) ndaj gjeografisë kulturore të dikurshme të alfabetit të Dhaskal Todhrit, mund të kumtojmë sot me pak a shumë siguri se në fund të shek. XVIII ky kod vështirë se shtrihej përtej qytetit të Elbasanit me rrethina (Shijon: Manastiri i Shën Gjon Vladimirit). Këtë rrethanë ka pranuar në thelb edhe Hahn-i në studimin e vet, anipse mëngon të mëtojë se “vetëm në jug në qytetin fqinjë të Beratit kuptohet dhe përdoret aty-këtu” (§ 2.1).

Asgjëmangut, edhe shtrirja e tij deri në Berat do parë më fort si hamendje pa forcë argumenti, meqë Hahn-i jo vetëm nuk dispononte ndonjë dokument a dëshmi në dorëshkrim, por duket apo mund të ketë qenë udhëzuar, pas gjase, gabim lidhur me praninë e një alfabeti (tjetër) origjinal që gjëllinte atëbotë në Berat, por që, pas gjase, nuk kishte të bënte assesi me alfabetin e Dhaskal Todhrit. Lejohemi t'i referohemi me këtë rast alfabetit origjinal, të fiksuar në Kodikun Beratas, i cili i takon po ashtu gjysmës së dytë të shek. XVIII (Demiraj 2019 30, 228v.) e që ka nxitur jo rrallë keqkuptime të ngjashme në studimet e mëvonshme shqiptare²⁷.

Si hamendje pa forcë argumenti do klasifikuar ndërkohë edhe afria që përsiat Hahn-i me një alfabet kishtar deri sot të panjohur me 30 karaktere grafike, që sinjalizonte dikur Giuseppe Crispi për arbëreshët e Italisë në shkrimet e veta, të cilin Hahn-i gjithashtu nuk e dispononte²⁸. Sa kohë që këtë alfabet ende nuk e njohim, është metodikisht më e qëlluar që ai të mënjanohet prej diskursit në fjalë, duke e pranuar kështu vetëm si një të dhënë historike-kulturore mbi një alfabet

²⁷ Shih shën. 6.

²⁸ Giuseppe Crispi: *Memoria sulla lingua albanese*, në: “Opuscoli di letteratura e di archeologia[...], Palermo 1836 126. Hahn-i mjaftohet këtu me dhënien e citatit përkatës italisht: “Esiste un alfabeto ecclesiastico composto di trenta lettere, le quali sono assai rassomiglianti ai caratteri fenici, ebraici, armeni e palmireni, alcune alla scrittura geroglifica jeratica, poche ai caratteri bulgari e mesogetici, ma vi manca ciò che la nostra curiosità vi cercherebbe di preferenza, cioè la rassomiglianza al carattere pelasgo ed etrusco e runnico. La scrittura non è già astiforme, ma vi predomina la linea retta, come ne' manoscritti greci, perciò noi crediamo che nella forma attuale essa sia l'opera dei preti cristiani o nel secondo secolo all'occasione della introduzione del cristianesimo, o nel nono quando la Messa cristiana d'Albania fu definitivamente congiunta alla Messa romana. Questo alfabeto però contiene alcuni elementi di alfabeti infinitamente più antichi usati in Illiria, in Macedonia ed in Epiro. — Malte-Brun Geografia universale, tomo I, pag. 25, sq. Milano 1828.” ([1836 126] 2003 139).

original të radhës, por assesi të ngjashëm e jo më të njëjtë më atë të Dhaskal Todhrit²⁹.

Për më tepër Hahn-i (1954 297) na mëson në shënimet e tij edhe gjallesën e një alfabeti me karaktere grafike origjinale e me përhapje të kufizuar në Gjirokastrë, të ashtuquajturin Alfabet i Veso Beut (Veso Bei), që një pinjoll i familjes së pashallarëve Alizoti e kishte mësuar në të ri të vet prej mjeshtrit të oborrit (hoxhës) që ishte po ashtu me origjinë shqiptare. Duke e përcjellë këtë alfabet edhe në formë tabelare, ai shkruan në vazhdim se bëhet fjalë këtu:

“[...] për një shkrim të fshehtë, të trashëguar në familjen e tij. Ai bart në fakt në disa shenja të tij (grafike) gjurmë të një moshe të madhe dhe një farë afrie me atë (të Dhaskal Todhrit) të shqyrtuar më lart; veçse, siç u përmend më sipër, përdorimi i shifrave arbitrare nuk është i panjohur në Shqipëri, andaj edhe këto shenja mund të meritojnë vëmendje të detajuar, në rast se mund të sillen dëshmi të një moshe të madhe. Prashtu autori (Hahn-i) heq dorë prej çdo gjykimi ndaj tij.”

Kjo e dhënë shtesë është një argument pozitiv më shumë që tumir mendimin se në periudhën në fjalë qarkullonte në do qendra urbane (ortodokse) shqiptare shkrimi shqip me alfabetë gjithfarësh për plotësimin e nevojave të shtresave të ndryshme shoqërore në komunikimin shpirtëror, tregtar e deri familjar. Sigurisht që arsyet e kësaj prirjeje në Arealin Kulturor të Jugut (ortodoks) shqiptar duan kërkuar më tej, veçse në rastin konkret nuk shfaqet ndonjë arsye themelore që të mos mbahet parasysh kujtesa kolektive në Elbasanin e gjysmës së shek. XVIII e më vonë që e lidhte atë traditë shkrimi në qytet me personazhin historik të Theodhor Haxhifilipit, alias Dhaskal Todhrit.

Së fundi lejohemi të shtojmë edhe dyshimin më të hershëm ndaj kësaj teze që na kumtohet në do shënime në një dorëshkrim greqisht të Konstandin Kristoforidhit mbi fjalëformimin e shqipes (pas 1884³⁰), përkatësisht në fund pas shtojcës gjermanisht “Rreth alfabetit shqip të Theodhor Filipit nga Elbasani” (f. 104-106) shkruhet në vazhdim:

“[fund i f. 106] “Këto janë mendime të dr. G. Ha[h]n, Konsull i Austrisë në Janinë”, ndërsa në f. 107 vijohet greqisht: “Sipas mendimit të Kristoforidhit ky alfabet është pjellë e kokës së Theodhor Filipit për këto arsye: ky alfabet në asnjë vend të Shqipërisë nuk është i njohur dhe as i përdorur, përveç vendit

²⁹ Shih §2.1.

³⁰ Lloshi (1989 162) sqaron që zotëruesi i fundit të këtij dorëshkrimi që sot ruhet në BAKSH ishte studiuesi i njohur gjerman Gustav Weigand. Prej dorës së tij mund të jenë hedhur në letër këto shënime gjermanisht, anipse emri i Hahn-it shkruhet gabim si <Han>.

të tij. Në qoftë se sipas supozimit të dr. Ha[h]n-it, Theodhor Filipi i solli ato në Voskopojë ose kanë qenë përdorur prej banorëve pas shkatërrimit të qytetit nga Tukeditët aty nga vitet 80', duhej të ishin të njohura dhe të përdorura nga diaspora e voskopopjarëve, ndërsa ata nuk kanë as idenë më të vogël për këtë alfabet." (sh. Lloshi 1989 161v.)

4.3.2 Shkrimi si përbërës i matriksit të kulturës etnike shqiptare

Siç u citua më lart (§4.e) Hahn-i i cakton kulturës së shkrimit shqip (qoftë edhe si vijues i pandërmjetëm i shkrimit pellazg) një pozicion qendror në matriksin e kulturës etnike shqiptare, duke e pranëvënë me do tipare të mënyrës së jetesës së shoqërive paraantike e që shfaqeshin në një formë të ngurtësuar edhe në do dukuri të jetës (malësore) shqiptare siç ishin marrëdhëniet farefisnore, hakmarrja e deri tek e drejta e të fortit (e grushtit). Parë nga kjo perspektivë, ai vijon, që:

"Në qoftë se shqiptari ka ruajtur në detaj aq shumë zakone dhe institucione të stërgjyshërve të tyre pellazgë, përse duhet të jetë e papërfytyrueshme që ai shkruan njëllon si ata. Neve na duket shumë më mahnitëse, që një popull, lulëzimi i të cilit gjëllin në dhe të huaj, në ngulime, martesë dhe varrime e rase të tjera të jetës së përditshme, i përmbahet zakoneve protoromake dhe helene, aq sa ndopak syresh mënyrën e shkrimit amtar e imitojnë të transponuar nga brezi në brez, sepse kjo kulturë shkrimi nuk është asesi një gjallesë e jetës së përditshme, ajo jetë larg jetës popullore shqiptare, nuk është asgjë tjetër veç një *curiosum*, të cilin e mësojnë jo për nevojë, por thjesht për kuriozitet dhe e ushtrojnë për argëtim. – Shumica as që mendon për përdorim praktik. Në shkollën e Elbasanit mësohet vetëm greqisht. Ky alfabet tregon si një nxënës të luajë me tjetrin; rishtari kërkon më së shumi të sajorë emrin e tij ase ndonjë tjetër fjalë, e me kaq plotëson kjo gjë rregullisht përdorimin e saj." (Hahn 1854 296)

Një analizë e mirëfilltë historike-tekstuale e pasazhit të mësipërm të çon natyrshëm në përfundimin se këtij operacioni logjik i mungon së paku baza historike-kulturore lidhur me përkatësinë e kulturës së shkrimit në matriksin të kulturës etnike të një shoqërie kryesisht aliterate në kohë dhe hapësirë. E tillë do konsideruar atëbotë edhe shoqëria shqiptare, në të cilën kultura e shkrimit daton gjithkund një periudhë relativisht të vonë.

Për më tepër Hahn-i jo vetëm gabon kur përsiat gjeografinë e

alfabetit elbasanas përtej zonës qytetare-urbane të Elbasanit, madje duke transponuar atë deri në trojet e diasporës historike shqiptare në Italinë e Jugut. Ndryshe nga përjasjet me shumë të panjohura, rezulton të jetë shumë më produktive pranëvënia e kësaj përvoje të lëvrimin të shkrimit shqip me zhvillimet kulturore brenda shtresave të ndryshme sociale në jetën urbane shqiptare të shek. XVIII-XIX, bash në një periudhë kur në Arealin Kulturor të Jugut shqipja shkruhej me një numër të konsiderueshëm alfabetesh të ashtuquajtur orgjinale (në mos të fshehta), siç ishin – përpos atij të Dhaskal Todhrit – edhe ai i anonimit elbasanas (i Grigorit të Durrësit ?) në Elbasan, ai i anonimit të Beratit (në Kodikun Beratas), ai i Veso Beut në Gjirokastrë deri edhe edhe i ashtuquajtur Alfabeti i Vellarait në Janinë, që pasohen në gjysmën e parë të shek. XIX me alfabetin origjinal të Naum Veqilharxhit.

Parë nga kjo perspektivë, alfabeti i Dhaskal Todhrit rezulton të jetë më fort pjesë e zhvillimeve që përjetoi kultura qytetare dhe besimi fetar në arealin në fjalë për arsye që kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm, por që i kapërcen caqet e këtij studimi modest.

4.3.3 Pamje të analizës epigrafike mbi alfabetin e Todhrit

Siç përmendëm qysh në fjalët hyrëse të kumtesës sonë, përjasja e alfabetit elbasanas (të Dhaskal Todhrit) me ata fenikas dhe protogreqisht së bashku me analizën e mirëfilltë të rrugëve të përfuturit të tij evokojnë njëherësh emrin e Johann Georg von Hahn-it si themelvënës in e epigrafisë shqiptare, parë kjo si disiplinë e veçantë e njohjes dhe studimit të dorëshkrimeve në kulturën e shkrimit shqip (§1). I ndërgjegjshëm për rrethanën se po përshkon një terren të pakultivuar më parë, ai mëngon të mëtojë se rezultatet e punës së tij janë paraprake dhe pritët të përjetojnë tumirjen e specialistëve “në shkencën e dorëshkrimeve. Andaj, sigurisht që vëzhgimet e mësipërme e me do zbrazëti të rastit do të mund të plotësohen dhe përmirësohen prej kësaj shkence.” (§4.2)

Dhe ndërmarrje të kësaj natyre nuk është se kanë munguar, anipse i takojnë kryesisht gjysmës së dytë të shek. XIX. Në këtë hulli ecën p.sh. në shek. XIX edhe sllavisti dhe epigrafisti i njohur Leopold Geitler (1883), i cili rrjedhon këtë alfabet si një përzierje mes alfabeve antikë të latinishtes dhe greqishtes në shek. VI-VII, ndërkohë që vetë ky alfabet paskësh shërbyer, sipas tij, si bazë për përfutimin e alfabetit glagolik të sllavishtes së vjetër në shek. IX. Të dyja tezat përjetuan shpejt edhe reagimet e rastit në botën shkencore të asaj kohe. Prashtu, ndërsa burimi i alfabetit glagolik u kundërshtua menjëherë prej sllavistit të njohur Jagić (sh. Nahtigal [1923] 2015b 69), të dyja tezat në fjalë mbi alfabetin elbasanas u përballën me kritikën e nxënësit të tij dhe albanologut të

asaj kohe Gjergj Pekmezit, i cili ndër të tjera shkruan se:

“...në kundërshtim me këto mendime dëshiron të kumtojë qëndrimin se ky (shkrim) nuk është gjë tjetër veç një stilizim krejt i dukshëm e që ka të bëjë me një ndërmarrje individuale që mbështetet në alfabetin modern të greqishtes së re, e si i tillë është e pamundur të ketë një moshe më të hershme se shek. XVII-XVIII.” (1901 59)

Prashtu një numër i madh shenjash si p.sh. sosh të tingujve /t/, /n/, /s/ etj., apo ligaturash si /st/ etj. rezultojnë të jenë, sipas tij, përshtatje të thjeshta prej shkrimit kursiv të greqishtes. Pavarësisht përkrahjes së këtij mendimi edhe prej ndonjë studiuesi të shkollës albanologjike austriake, si p.sh. Raiko Nahtigal ([1923] 2015b 61vv.), mund të shtojmë këtu se analiza epigrafike-historike e Pekmezit nuk rrok të gjithë inventarin e shenjave grafike të këtij alfabeti në tërësinë e vet, duke u përqendruar kryesisht në ato shenja të thjeshta ose dyshe, të cilat vetë Hahn-i i konsideron si përshtatje organike e pa ndryshime prej alfabetit fenikas.

Së fundi shënojmë edhe mendimin e përkundërt dhe po aq të gabuar të Shuteriqit (1954 42), sipas të cilit “edhe alfabeti i Todhrit është krijuar sipas fytyrës s’alfabetit sllav” (1954), duke mos i përcjellë lexuesit rezultatet e ndonjë analize të mirëfilltë epigrafike.

4.3.4 Projektioni 1 x 1 i marrëdhënies shenjë grafike : fonemë në lashtësi

Edhe pse Hahn-i vëren si “3.[...]deri në pamundësi reale që një radhojë shkronjash – përgjatë një tradite shkrimore 3000 vjeçare, pra prej së paku 90 brezash – të ketë ruajtur konturet e veta me një qartësi të tillë, sa që sot e gjithë ditën ato në shumësinë e tyre arrijnë të dallohen lehtësisht prej trajtave burimore. (§4.1), ai përsëri ngulmon në përsiatjen e tij të formësuar në bindje, se “5. Alfabeti i shqipes përshtatet plotësisht me alfabetin fenikas dhe me sosh të afërt me të, çka vjen me thënë, se ndër 52 shenjat (shkronjat) e alfabetit të shqipes shumica e tyre nuk mbetet jashtë bashkëlidhjes së pandërmjetme me të e me alfabete bashkëkohorë të asaj periudhe.” Për rrjedhojë edhe ky alfabet i takon, sipas Hahn-it, së njëjtës familje. (§4.2)

Në kohën tonë nuk e kemi assesit të vështirë t’i anashkalojmë këtij argumentimi logjik që përkon me formimin intelektual të Hahn-it dhe paradigmen e kërkimit shkencor në kohën e tij, bash në një periudhë kur marrëdhëniet shkronjë/shenjë grafike : fonemë/vlerë tingullore në diskursin shkencor-intelektual projektoheshin përgjithësisht, më saktë

ende në raportin 1 x 1 ndërmjet realitetit bashkëkohor dhe atij historik të para 3000 vjetëve. Prashtu në kohën tonë, më saktë prej gjysmës së dytë të shek. XIX (Bopp 1854; sidomos Meyer 1891), ne jemi në gjendje të sigurojmë – falë metodave të rindërtimit të brendshëm dhe krahasimit ndërgjuhësor në kuadrin e zhvillimit dinamik që ka përjetuar shqipja si pinjoll i familjes gjuhësore indoeuropiane – një sistem fonetik dhe inventar fonemash për protoshqipen e mijëvjeçarit të dytë p.e.s., i cili dallon katërcipërisht prej atij sistemi fonetik dhe inventari fonemash që rezultojnë mirëfilli në gjysmën e shek. XIX. (Demiraj 1997 11vv.)

Janë pikërisht këto rrethana që e mënjanojnë përfundimisht besueshmërinë e përsiatjeve të Hahn-it lidhur me burimin e pandërmjetshëm të alfabetit shqip të Dhaskal Todhrit prej alfabetit antik fenikas.

5. Fjalë përmbyllëse

Nga sa u parashtrua më lart, Johann Georg von Hahn debuton me përshkrimin dhe studimin e alfabetit shqip të Dhaskal Todhrit në një fushë të palëvruar të epigrafikës shqiptare si disiplinë e veçantë shkencore në kulturën e shkrimit shqip, duke mëtuar njëherësh edhe rolin e gurëvënësit të saj në albanologji si shkencë komplekse rajonale. Edhe pse rezultatet e punës, përkatësisht përsiatjet e tij ndaj përkatësisë së kulturës së shkrimit shqip, sikurse vetë burimit fenikas të këtij alfabeti si pjesë konstitutive e matriksit të kulturës etnike pellazge në bashkësinë shqiptare të shek. XIX, nuk përkojnë më me realitetin shkencor që sendërtojnë shkencat albanologjike bashkëkohore, Hahn-i ka meritën që u përpoq me sukses të ndërkallë në kërkimet albanologjike sistematikën e studimit epigrafik të dorëshkrimeve me alfabet origjinal në kulturën e shkrimit shqip. Falë kësaj sistematike në hulumtim ai bëri së paku të dukshme dhe të prekshme përsosmërinë e realizimit të atij kodi alfabetik që kujtesa kolektive qytetare në Elbasan ia vishte dikur e, pas gjase, jo pa të drejtë Dhaskal Todhrit si qytetar dhe klerik erudit i këtij qyteti në gjysmën e dytë të shek. XVIII.

Që përsiatjet e Hahn-it ndaj këtij alfabeti nuk përjetuan të njëjtën jetëgjatësi si shumë e shumë pjesë të tjera të veprës së tij madhore “Albanesische Studien” (bl. I-III, 1853-1854), kjo ka të bëjë jo aq me kapacitetet intelektuale të këtij studiuesi albanolog të jashtëzakonshëm, se sa me formimin e tij, më saktë me mjedisin shkencor-intelektual ku vepronte e në të cilin dhe për të cilin faktet, fenomenet dhe rrethanat shoqërore bashkëkohore transponoheshin si të tilla në faza të kryehershme të realitetit etnik-gjuhësor, duke mos mbajtur parasysh sa e siç duhet dinamikën e zhvillimit shoqëror, përkatësisht

atë të vetë gjuhës si dukuri e tillë. Kjo dinamikë zhvillimi sapo kishte hyrë ndërkohë së bashku me paradigmen e re në studimin historik-krahasues të gjuhëve që formëzonin së bashku të ashtuquajturat ‘familje gjuhësore’ siç ishte, ndër të tjera, rasti i shqipes në gjirin e familjes gjuhësore indoeuropiane (Bopp 1854). Sa dhe si u shfrytëzua vepra e Hahn-it në kuadrin e studimeve brenda kësaj paradigme të re, këtë e dëshmon zhvillimi i vrullshëm i shkencave albanologjike prej gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e deri në ditët tona.

6. Bibliografi e cituar

Camarda, Demetrio

Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese. Prato 1866.

Crispi, Giuseppe

1836 Memoria sulla lingua albanese, në: “Opuscoli di letteratura e di archeologia[....], Palermo.

2003 Studi Albanesi – storici folclorici linguistici (a cura di Matteo Mandalà), në radhë: “Studi e testi albanesi” (Collana diretta da Matteo Mandalà), tomo 3. Palermo.

Demiraj, Bardhyl

1997 Albanische Etymologien. Rodopi, Amsterdam – Atlanta.

2019 Kodiku Beratas – Ο Μπερατινός κώδικας (me një botim kritik të pjesës shqip të përgatitur nga Bardhyl Demiraj), ASHSH Tiranë.

Elsie, Robert

2016 Early Albanian Bible Translations in Todhri Script, në radhë: “Albanian Studies” nr. 30. London.

2017 Albanian Alphabets. Borrowed and Invented. në radhë: “Albanian Studies” nr. 35. London.

Faulmann, Carl

1880 Das Buch der Schrift, Bd. 2. Wien 1880.

Geitler, Leopold

1883 Die albanesischen und slavischen Schriften. Wien.

Hahn, Johan Georg von

1849 Sitzungsberichte der histor.-philosoph. Classe der kais. Akademie der Wissenschaften. Wien. Bd. III, Jahrg. 1849; H. 6-10, f. 262-263.

- 1850 Bemerkungen über das albanesische Alphabet. (Aus dem Dezember-Hefte des Jahrganges 1850 der Sitzungsberichte der histor.-philosoph. Classe der kais. Akademie der Wissenschaften. Wien. Bd. V; H. 6-10, f. 841vv. – gesondert abgedruckt). Wien.
- 1854 Albanesische Studien, Bd. I. Wien.

Hetzer, Armin

- 1988 Armenier und Albaner. Philologisch-historische Materialien zur Stellung zweier Minderheiten im Osmanischen Reich, në: "Balkan-Archiv" N.F. 12 [1987] 31-148.

Kristoforidhi, Konstandin

- 1884 ? To Etymologikon meros tis Alvanikis glossis [Pjesë etimologjike e gjuhës shqipe], në BKSH 81 ,374.8 -022.215 =18 =14; 811.18 ,374.8 -022.215 =14; 811.18 ,373.6 -11

Lloshi, Xhevat

- 1989 Dorëshkrimi i K. Kristoforidhit për fjalëformimin e shqipes, në: "Studime Filologjike" 1, f. 159-195.

Nahtigal, Rajko

- 2015a Çashtja e një gjuhe të përbashkët letrare shqipe, në: "Për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe / Über eine einheitliche albanische Sprache" (përgatitur nga Rexhep Ismajli et al.) [Graz 1917] Prishtinë – Ljubiana 2015, f. 23-57.
- 2015b Mbi Alfabetin e Elbasanit dhe letërshkrimin e tij në të, në: "Për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe / Über eine einheitliche albanische Sprache" (përgatitur nga Rexhep Ismajli et al.) Prishtinë – Ljubiana 2015, f. 160-195. (bot. I parë në: "Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnolosiju", urednik H. Barić, Kniga I, cd. 1-2, Beograd)

Nosi, Lef

- 1918 Dhaskal Todhri [Mesha e Shën Gjon Gojëartit], në: "Kopshti letrar" [1918] (nr. 1) 13-14; (nr. 2) 12; (nr. 3) 5; (nr. 4) 11; (nr. 5) 2. Elbasan.

Osmani, Tomor

- 2008 Udha e shkronjave shqipe. (bot. i dytë). Tiranë.

Pekmezi, Gjergj

- 1901 [Raport ekspedite në terren, në:] Sitzung der philosophisch-historischen Classe vom 20. März.

Kaiserliche Akademie der Wissenschaften in Wien,
Jahrgang 1901, Nr. IX, S. 37-64.

Qafëzezi, Ilo-Mitkë

1937a "Drita" nr. 239, tetor, f. 3.

1937b Theodhor Kavalioti dhe Dhaskal-Todhri Haxhifilipi, në:
"Përpjekja shqiptare" nr. 11-12, f. 247-250.

Resuli, Namik

1938 Abeceja e dorëshkrimit beratas dhe abeceja e Thodhër
Haxhi Filipit, në: "Leka" nr. 10, f. 181-185, Shkodër.

Shuteriqi, Dhimitër S.:

1949 Anonimi i Elbasanit; shkrimi shqip n'Elbasan në shekujt
XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri, në: "Buletin i Institutit të
Shkencave" 1 [1949] 35-54

1954 Dhaskal Todhri, në: "Buletin për Shkencat Shoqërore" 4
[1954] 35-55

1959 Shkrime të Dhaskal Todhrit dhe të pasardhësve elbasanas,
shoqëruar me fjalorin e shkrimeve të Todhrit, në: "Buletin
i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria Shkencat
Shoqërore" 1 [1959] ,165-198

1976 Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850. Tiranë.

Xhago, Vullnet

2019 'Alfabeti i Dhaskal Todhrit' Vepër e Akademisë së
Voskopjës. Refleksion. Tiranë.

Një tekst i shkurtër shqip dhe emri “shqiptar” në një dorëshkrim të vitit 1639

Raportet e vizitorëve kishtarë në Shqipëri janë burime të rëndësishme të dhënash jo vetëm për historinë kishtarë të kishës katolike por edhe për rrethanat politike e sociale të Shqipërisë veriore në shekujt XVII-XIX¹. Tashmë publiku ka në dispozicion të gjitha raportet e vizitorëve apostolikë në Shqipëri, botuar në 5 vëllime nga historiani i shquar albanolog Peter Bartl, i ndarë nga jeta pak kohë më parë². Këto dokumente, në një pjesë të madhe, mbeten ende për t’u shqyrtuar e vlerësuar nga studiuesit e fushave të ndryshme të albanologjisë.

Fondet arkivore italiane përmbajnë një mori dokumentesh kishtarë që i takojnë Shqipërisë, të cilat dora dorës po dalin në dritë nga studiuesit e kërkuesit e interesuar. Tani së fundi gjurmuesi i pasionuar Mark Palnikaj ka siguruar dhe përgatitur për botim një relacion të shek. XVII, që u përket misioneve françeskane në Shqipëri, mbledhur dhe sistemuar nga Atë Giacinto da Sospello, Prefekt i Misionit Apostolik të Fretërve Reformatë në Shqipëri në vitin 1652. Ky relacion, i gjetur dhe i përshkruar së pari përmbledhtas nga orientalisti polak Tadeusz Lewicki³, përmban një numër relacionesh të etërve misionarë të këtij misioni nga viti 1634 deri 1650, gjatë 15 vjetëve të veprimtarisë së tyre misionare në Shqipëri. Dorëshkrimi titullohet: *Relatione Universale dell’ origine e successo della Missione Apostolica de Frati Min[o]ri Oss[ervan]ti Rifor[ma]ti Serafico P[ad]rè S. Francesco nel Regno d’Albania*. Da diuersi relationi d’alcuni Padri Missionarij di detta Missione raccolta, ordinata et aumentata dal P. Fra Giacinto da Sospello del med[esi]mo ord[i]ne della Prou[inci]a di S. Tom[ma]

¹ P. Bartl, “Toleranz und Repression. Die Türkenherrschaft im Spiegel der geistlichen Visitationsberichte aus Nordalbanien”, në: B. Demiraj (ed.) *Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie*, Albanische Forschungen 32, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2012, f. 341-342.

² P. Bartl, *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Nordalbanien (1-5)*, (Albanische Forschungen 26), Harrassowitz, Wiesbaden, 2007-2021.

³ T. Lewicki, “Un manuscrit inconnu du XVIIe siècle concernant l’Albanie et l’histoire des missions franciscaines dans ce pays”, *Revue des études islamiques*, Volume 16 (1948), f. 55-58.